

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE

№ Nr: 08-1317/2
Data/Date: 18 / 12 / 2023
Shënime/Notes: -4-



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira - Departmentant Slobodnih Profesija - Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.26/2023

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbarduesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbarduesit privat si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbardimore të lëndën përmbardimore, P.nr.16/2017, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat Burbuqe Spahija - Kërveshi.

- Kërveshi, Përmbarduesi Privat, përmbarduesi privat, dhe në mungesë të palës ankuese nga me datën 15.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, DPL-26/2023 i datës 10.10.2023, dhe ankesa e datës 05.10.2023, e palës ankuese nga lidhur me iniciimin e procedurës disiplinore ndaj përmbarduesit privat si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në si të pa bazuara.

II. Përmbarduesi Privat si organ përmbardues, nuk është përgjegjës për shkeljet e pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra të lëndën përmbardimore nga P.nr. 16/2017.

Arsyetim

Pretendimet e inicuesit të Procedurës disiplinore.

Pala ankuese pretendon se përmbaruesi privat lëndor, ka bërë shkelje disiplinore me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore te rasti P.nr.16/2017, ngase i njëjti nuk e ka realizuar pagesën nga ana e debitorit për kundër që vetë debitori kishte deklaruar për ditët e pagesës. Mbi këto pretendime pala ankuese kërkoi nga komisioni që të detyrohet përmbaruesi që ta ekzekuton përmbarimin dhe të arkëtohet shuma e deklaruar nga vetë debitori, në çështjen lëndore pasi që afati i përmbushjes së detyrimit lëndor i dhënë nga vet debitori ka skaduar, andaj edhe të merren masa disiplinore ndaj përmbaruesit privat.

Me datën 10.10.2023, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar, ndaj përmbaruesit privat, lidhur me veprimet përmbarimore për këtë rast, të cilin raport e kanë prezantuar edhe në seancën dëgjimore.

Pretendimet e Përmbaruesit Privat, palë në këtë procedurë

Përmbaruesi Privat, si në përgjigje me rastin e inicimit të procedurës disiplinore, ashtu edhe në seancë dëgjimore, e ka kundërshtuar në tërësi raportin për inicimin e procedurës disiplinore, duke potencuar se pretendimet e palës ankuese janë të pabazuara sepse ka qenë e pamundur që të inkasohet obligimi i mbetur nga debitori, për kundër që vetë debitori ka deklaruar afatin për pagesë, i njëjti vullnetarisht nuk ka bërë pagesë, por përmes llogarive bankare apo veprimeve tjera përmbarimore ka qenë e pamundur të realizohen pagesa, pasi që nuk ka pasur asnjë qarkullim. Përmbaruesi më tutje ka theksuar se e ka njoftuar kreditorin që nëse i njëjti ka informata lidhur me pasurinë eventuale të debitorit ta njoftoi përmbaruesin privat për procedimin e mëtejshëm të kësaj çështjeje. Gjithashtu ka tentuar që të kontaktoi me debitorin edhe përmes djalit të debitorit dhe është informuar se debitori ka vdekur me datë 08.01.2023, siç konstatohet nga certifikata e vdekjes e datës 27.10.2023. Për këto arsye përmbaruesi privat ka deklaruar se ankesa e palës ankuese dhe raporti i ministrisë së drejtësisë janë të pabazuara, andaj ka kërkuar që të refuzohen, si të pabazuara.

Baza ligjore që një përmbarues privat mund të bëjë shkelje disiplinore

Neni 367 paragrafi 1 pikat nga 1 deri 11, i Ligjit të Procedurës Përmbarimore, i përcakton shkeljet përmbarimore për përmbaruesit privat, si janë në vijim:

- 1.1. Nëse përmbaruesi privat tejkalon autorizimet e besuara me këtë ligj;

- 1.2. Nëse gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij përmbaruesi privat nuk i përmbahet ligjit;
- 1.3. Nëse përmbaruesi privat gjatë procesit të emërimit nuk ka zbuluar në mënyrë të qëllimshme pengesat ligjore të cilat janë kusht i emërimit të tij;
- 1.4. Nëse përmbaruesi privat ka shkelur detyrat e parashikuara me këtë ligj duke rrezikuar besimin në paanshmërinë e tij dhe në veprimet të cilat ai i ndërmerr;
- 1.5. Nëse përmbaruesi privat ndërmerr veprime në procedurë pavarësisht arsyeve për përjashtim;
- 1.6. Nëse përmbaruesi privat shkel detyrën e mbajtjes së sekretit zyrtar;
- 1.7. Nëse përmbaruesi privat kërkon kompensim më të lartë se sa ai i paraparë në tarifë;
- 1.8. Nëse përmbaruesi privat pa shkaqe të arsyeshme refuzon aftësimin profesional;
- 1.9. Nëse përmbaruesi privat nuk mban evidencat për lëndët e përbarimit në të cilat ai punon apo evidencat e lëndëve në të cilat ai/ajo punon nuk janë në rregull;
- 1.10. Shkelja e detyrave të përcaktuara me dispozitat tjera dhe
- 1.11. Nëse përmbaruesi privat në pajtim me aktin e odës nuk e paguan anëtarësinë.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit Disiplinor për Përmbarues Privat

Pas seancës dëgjimore dhe analizimit të dispozitës së lart cituar, Komisioni Disiplinor, me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve dhe ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ashtu që pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim që Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore, për këto arsye:

Nuk është kontestuese në mes palëve në procedurë dhe për komisionin disiplinor, se Departamenti për Profesione të Lira – Divizioni për Noteri dhe Përbarim Privat, për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës për Profesione të Lira, për Përmbaruesit Privat nga Ministria e Drejtësisë, se pala ankuese është në cilësinë e kreditorit tek rasti përbarimor P.nr.16/2017, për këtë çështje juridike.

Kontestuese mbetet në këtë rast, se a kemi të bëjmë me shkelje disiplinore, pasi që përmbaruesi privat sipas palës ankuese nuk është i njoftuar me procedurën e përbarimit lëndor.

Komisioni Disiplinor vlerëson se në këtë rast, pas analizimit të dispozitës së lartcekur ligjore, ndarjen e çështjeve jo kontestuese dhe atyre kontestuese si më lart, vjen në përfundim se në këtë çështje juridike, nuk kemi të bëjmë me shkelje disiplinore. Kjo nga shkak se pala ankuese ka

qenë e njoftuar në vazhdimësi nga përmbaruesi privat, lidhur me zhvillimin e procedurës përmbarimore dhe për pamundësinë e pagesave dhe vdekjen e vetë debitorit siç u konstatua më lart. Andaj komisioni vjen në përfundim se ankesa e palës ankuese dhe raporti i Ministrisë së Drejtësisë, janë të pabazuara, sepse mos ekzekutimi i urdhrin nga përmbaruesi nuk është si shkak i neglizhencës eventuale të përmbaruesit, por si rezultat i pa mundësisë së ekzekutimit në mungesë të mjeteve financiare nga ana e debitorit.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr.26/2023 datë 15.12.2023



Kryesuesja e Komisionit Disiplinor
Manushe Kiraçi

Manushe Kiraçi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par. 5 të LPP-së.